



4 mars 2016

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### **AKP publikoi raportet e shitjeve të të gjitha pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore si dhe raportet e shitjeve të pronave ku ka pasur uzurpatorë në kohën e përfundimit të shitjes**

**Prishtinë** - Agjencia Kosovare e Privatizimit, në kuadër të publikimeve të informatave për procesin e zhvilluar të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës, publikoi sot në faqen e saj të internetit Raportet përmbledhëse dhe detajet lidhur me shitjen e pronave shoqërore.

Publikimet e sotme që mund të gjenden në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org), (kapitulli *Raportet*) janë:

1. 160304 Raportet përmbledhëse dhe detajet e shitjes së të gjitha pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore që nga viti 2002; dhe
2. 160304 Raportet përmbledhëse dhe detajet e shitjes së pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore që ka pasur UZURPATORË në kohën e përfundimit të shitjes.

Agjencia Kosovare e Privatizimit paraprakisht ka konsultuar Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila ka dhënë opinionin ligjor se publikimi i emrave të uzurpatorëve të cilët në mënyrë të jashtëligjshme i kanë shfrytëzuar apo aktualisht i shfrytëzojnë pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe publikimi i emrave të blerësve të cilët kanë privatizuar (blerë) ndërmarrjet shoqërore ose asetet e tyre nuk është në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

AKP dëshiron që përmes këtij njoftimi të rikonfirmoj përkushtimin për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies para opinionit publik për gjithë procesin e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore që është i një rëndësie të veçantë për administrimin në mirëbesim të aseteve në pronësi shoqërore dhe rritjen e vlerës së tyre.

Listat e publikuara do të azhurnohen periodikisht, ndërkaq ftohen palët e interesit që në rast të vërejtjeve në saktësinë e shënimeve të publikuara, të dërgojnë me shkrim vërejtjet e tyre në zyrat rajonale të Agjencisë. Agjencia do të korrigjoj ndonjë lëshim eventual me rastin e publikimit periodik të këtyre listave.

Agjencia fton të gjitha palët që të përkrahin, ndihmojnë dhe të kontribuojnë në procesin e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies që AKP do ta fuqizoj edhe më tej.

**FUND**